

VENDIM
Nr. 367, datë 20.6.2018

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT, PËR PROJEKTIN E RRUGËS “PORTI I JAHTEVE – *BAY-PASS* ORIKUM –
DUKAT
(URA E SHËN ELIZËS)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe në vijim të nenit 15, të rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 6% (gjashtë për qind) të pikëve, që i jepet shoqërisë “Gjikuria” sh.p.k. për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën për dhënien me koncesion/ partneritet publik privat për projektin e rrugës “Porti i jahteve - *bay-pass* Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)”.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi